

# DOKUMENT AKTUAL

## Roli i oficerëve të policisë në trajtimin e të kthyerve xhihadistë

### Hyrje

Në Evropë ekziston një shqetësim serioz dhe në rritje rreth shtimit të mundshëm të numrit të të kthyerve nga i ashtuquajtura kalifat. Parashikohet se burra, gra dhe fëmijë do të duan të kthehen në lagjet e tyre të vjetra: disa të kthyer mund të burgosen; disa mund jenë të zhgënjyer, të traumatizuar ose të penduar, ndërsa të tjerë mund të jenë radikalë të devotshëm ose madje edhe terroristë në gjendje të fjetur.

Shtetet evropiane duhet të jenë të përgatitura që:

1. të pranojnë dhe të monitorojnë të kthyerit (procedurat dhe protokollet);
2. të vlerësojnë rreziqet e të kthyerve, vulnerabilitetet dhe potencialin për risocializim të suksesshëm;
3. të zbusin rreziqet dhe të fillojnë risocializimin e tyre (programet e daljes);
4. të implementojnë masa dhe ndërhyrje për të mbrojtur familjet dhe personat e afërt të të kthyerve dhe për të mbrojtur publikun e gjerë.

Këto veprime bien nën tutelën e shumë autoriteteve dhe organizatave, dhe jo vetëm të policisë. Por në lidhje me përfshirjen e policisë, cilat përgjegjësi dhe kontribute kërkohen?

Në këtë dokument, Radicalisation Awareness Network Centre of Excellence (RAN CoE) ndan konstatimet e Grupit të Punës të Radicalisation Awareness Network Police and Law Enforcement (RAN POL), bazuar në një takim me oficerë policie me përvojë në Düsseldorf, Gjermani në datat 30 dhe 31 mars 2017.

### Akronimet

|           |   |
|-----------|---|
| AIVD      | Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë               |
| CVE       | lufta kundër terrorizimit të dhunshëm                                       |
| HTS       | Hayat Tahrir al-Sham  |
| ISIS      | Shteti Islamik në Irak dhe Siri   |
| NCTV      | Koordinatori Kombëtar Holandez për Sigurinë dhe Kundërterrorizmin           |
| OJQ (NGO) | organizatë joqeveritare   |
| NPCC      | Këshilli Kombëtar i Shefave të Policisë                                     |
| RAN CoE   | Radicalisation Awareness Network Centre of Excellence                       |
| RAN POL   | Radicalisation Awareness Network Police and Law Enforcement (Grupi i punës) |
| RAN YF&C  | RAN Youth, Families and Communities (Grupi i punës)                         |
| RAN       | Radicalisation Awareness Network  |
| TPIM      | Masat e Hetimit për Parandalimin e Terrorizmit                              |
| VERA      | Vlerësimi i Rrezikut të Ekstremizmit të Dhunshëm                            |

Ky dokument është shkruar nga **Steven Lenos dhe Wessel Haanstra**, nga RAN Centre of Excellence.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e RAN Centre of Excellence, të Komisionit Evropian apo të ndonjë institucioni ose pjesëmarrësi tjetër të grupit të punës të RAN POL.

## Prezantim në këtë dokument

Ky dokument është prodhuar nga Grupi i punës së RAN POL (pika kyçe e RAN POL është policia dhe autoritetet e zbatimit të ligjit<sup>1</sup> dhe bazohet në përvojën policore. Ky dokument u drejtohet forcave policore në Evropë, atyre që punojnë me policinë, dhe atyre që hartojnë politikat për policinë ose përfaqeset e përfshira në rolin e policisë.

Nëse një i kthyer kthehet në tokën amtare, dhe nuk burgoset...

... ai duhet të jetojë në shoqëri.

... në zonë, në një shtëpi, në një lagje, ndoshta me prindërit dhe vëllezërit më të vegjël, do të ecë nëpër rrugë, do të takohet me njerëz, do t'i kthehet shkollës për të përfunduar arsimin që të jetë në gjendje të gjejë punë.

*A kemi ne besim te të kthyerit që do të ecin lirshëm nëpër rrugë? A jemi të sigurt për qëllimet e tyre? A ka ndonjë rrezik se mund të jenë ende të radikalizuar? Apo që mund të riradikalizohen? Që ata mund të fillojnë të rekrutojnë të tjerë, t'i bëjnë rrjetet lokale ekstremiste më të forta ose madje t'i drejtohen dhunës spontanisht apo siç janë udhëzuar nga ndonjë organizatë terroriste si ISIS apo al-Qaeda? Si mund të organizojmë me sukses risocializimin, shkëputjen dhe deradikalizimin? Si mund t'i ulim rreziqet? A janë të gjithë të ndërgjegjshëm për situatën dhe të informuar e të përgatitur për rolet e tyre?*

Në Dyseldorf, RAN POL mbledhi ekspertë të policisë për të ndarë përvojat dhe mësimet e nxjerra.

### Katër tema

Pas një prezantimi të shkurtër rreth të kthyerve, ky dokument do të përqendrohet te roli dhe kontributi i policisë në kryerjen e katër detyrave të mëposhtme:

1. Grumbullimi i informacionit dhe përgatitjet pas nisjes së dikujt për në Siri ose Irak, përpara kthimit dhe pas kthimit
2. Vlerësimet
3. Puna e daljes
4. Ruajtja dhe mbrojtja.

Ekzistojnë shumë faktorë që duhen pasur parasysh në këto katër fusha, p.sh. bashkëpunimi multi-agjenci. Këto nuk janë sfida krejtësisht të reja dhe nuk janë të tilla as reagimet e kërkuara. Kjo është arsyeja pse edhe mësimet e nxjerra më parë dhe të ndara brenda komunitetit të specialistëve të RAN do të luajnë një rol të rëndësishëm<sup>2</sup>. RAN EXIT dhe RAN Youth, Families and Communities janë dy grupe pune me përvojë që lidhen veçanërisht me këtë subjekt.

<sup>1</sup> Radicalisation Awareness Network (RAN). (12 maj 2017). Police and Law Enforcement - Grupi i Punës (RAN POL). Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran/ran-pol\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-pol_en)

<sup>2</sup> Radicalisation Awareness Network (RAN). (12 maj 2017). Dokumentet e çështjeve dhe politikave. Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers_en) online.

## Krijimi i skenës

Për momentin, numri i të kthyerve nga Siria dhe Iraku është i kufizuar. Por, ka indicie se ka persona që janë gati të kthehen vullnetarisht, të cilët nuk e kanë bërë ende këtë për një numër arsyesh. Disa të kthyer të mundshëm nuk lejohen të largohen, dhe as të hyjnë në shtetin e tyre të origjinës/banimit. Ata e dinë se sapo të mbërrijnë do të burgosen. Disa lëvizin në fushëbeteja të tjera, ndërsa të tjerë vdesin gjatë konfliktit. Ka gjithashtu edhe nga ata që duan të kthehen në shtëpi, dhe prindërit e tyre po u bëjnë thirrje qeverive t'i mbështesin në këtë çështje. Shumica e shteteve nuk janë shumë të gatshme që ta plotësojnë këtë kërkesë, dhe disa të tjera madje provojnë të vendosin një ndalim rihyrjeje në vend për këta persona.

Por është e pashmangshme që do të ketë një rritje në numrin e të kthyerve që kanë jetuar dhe luftuar me ISIS-in ose grupin e lidhur me al-Qaeda Hayat Tahrir al-Sham (HTS), njohur më parë si Jabhat Fateh al-Sham, me emrin e mëparshëm Jabhat-al Nusra).

Ne nuk jemi të sigurt se çfarë do të sjellë e ardhmja. Në takimin e RAN POL në Dyseldorf, policia kujtoi përvojat dhe vëzhgimet me të kthyerit ekzistues. Rrethanat e tyre janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Mësuam se të kthyerit më të fundit (pra ata të këto dy viteve të fundit) nga shumë shtete ishin të zhgënjyer me projektin e ashtuquajtur të kalifatit dhe ishin lodhur së jetuari në zonën e luftës së ISIS-it. Por, shumë prej tyre nuk ishin deradikalizuar, që do të thotë se dukej se nuk distancoheshin nga ideologjitë radikale islamike; ata shpesh lidheshin sërish me kontaktet dhe rrjetet e vjetra radikale.

Studimet nga Zyra Federale e Policisë Kriminale Gjermane (BKA)<sup>3</sup> dhe përvojat nga shtetet e tjera tregojnë të njëjtën strukturë mikse. Por, ndonjëherë mund të vërehen elemente të caktuara të përbashkëta:

- Shumë janë të zhgënjyer me kalifatin, por jo me ideologjinë e tij dhe botëkuptimin e tij antiperëndimor;
- Të kthyerit nuk priten si heronj nga rrjetet dhe kontaktet e tyre të vjetra;
- As komunitetet e tjera nuk janë mikpritëse për ta;
- Të kthyerit ndonjëherë janë nën presionin dhe frikësimin e rrjeteve lokale ekstremiste ose nga ISIS-i;
- Ka një mbivendosje në rritje me grupet kriminale;
- Të kthyerit ngurrojnë të ofrojnë informacione rreth veprimeve të tyre në Siri ose Irak;
- Familjet dhe të kthyerit bashkëveprojnë me policinë dhe autoritetet për t'i mbështetur me kthimin, por sapo të kthyerit mbërrijnë, ky kontakt dhe vullnet për të bashkëpunuar shpesh me policinë dhe autoritetet zvogëlohet.

<sup>3</sup> Zyra Federale e Policisë Kriminale (BKA), Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës (BfV) dhe Qendra Informuese dhe e Kompetencave Kundër Ekstremizmit (HKE). (2016). Analizë e sfondit dhe e procesit të radikalizimit mes personave që u larguan nga Gjermania për të shkuar në Siri ose Irak për motive islamike (Versioni i datës 4 tetor 2016), 29-30. Marrë nga [https://www.bka.de/SharedDocs/Downloads/DE/Publikationen/Publikationsreihen/Forschungsergebnisse/2017\\_AnalysisOfTheBackgroundAndProcessOfRadicalization.pdf?blob=publicationFile&v=2](https://www.bka.de/SharedDocs/Downloads/DE/Publikationen/Publikationsreihen/Forschungsergebnisse/2017_AnalysisOfTheBackgroundAndProcessOfRadicalization.pdf?blob=publicationFile&v=2)

## **Të kthyerit e kohëve të fundit kanë profil të ndryshëm dhe rrezik më të lartë**

Ata që kthehen në të ardhmen mund të kenë një profil të ndryshëm nga vala e parë e të kthyerve. Dhe ka arsye për t'i konsideruar të kthyerit në të ardhmen një rrezik shumë më të lartë për sigurinë kombëtare siç u theksua nga agjencia holandeze e inteligjencës AVID në publikimin e vitit 2017 mbi të kthyerit<sup>4</sup>. Këta të kthyer përbëjnë një kërcënim më të madh se ç'ishte më parë; ata qëndruan në zonën e konfliktit për më shumë kohë, morën trajnim për armët, fituan përvojë në luftim dhe ndërtuan rrjetin e tyre xhihadist. Ata janë kalitur në beteja dhe mund të kenë marrë trajnim ideologjik dhe ushtarak. Kjo është e vërtetë edhe për fëmijët e të kthyerve nga mosha nëntë vjeçare, që kanë përjetuar trauma nga lufta dhe kanë qenë dëshmitarë të ekzekutimeve dhe të ndëshkimeve: disa madje janë detyruar të ekzekutojnë njerëz. Koordinatori Kombëtar Holandez për Sigurinë dhe Kundërterrorizmin (NCTV) dhe AIVD publikuan një raport rreth këtyre fëmijëve<sup>5</sup> për të rritur ndërgjegjësimin rreth sfidave dhe rreziqeve për të ashtuquajturit “këlyshë të kalifatit”.

## **Urgjencë më e lartë, rreziqe më të larta, më shumë punë: mbështetja në përjasjet e vërtetuara të daljes dhe të luftimit të ekstremizmit të dhunshëm (CVE)**

Figura 1 (faqe 6) është marrë nga fleta e fakteve “Përjasja gjithëpërfshirëse për të kthyerit”<sup>6</sup> publikuar nga

koordinatori holandez i kundërterrorizmit. Përjasja me të kthyerit është pak a shumë njësoj si ajo që po zhvillohet dhe përmirësohet për individët radikalë që duan të udhëtojnë ose që janë ndaluar të largohen drejt të ashtuquajturit kalifat. Holandezët e portretizojnë përjasjen ekzistuese të menaxhimit të rastit multi-agjenci si tashmë operacionale.

Në takimin e RAN POL, specialistët i bënë jehonë rëndësisë së përdorimit të strukturave dhe procedurave ekzistuese: *Ne nuk kemi nevojë për përjasje dhe institucione të reja drastike. Me bindje më të madhe, ne duhet të aplikojmë përjasjet e suksesshme dhe t'i përshtatim ato për t'u bërë ballë të kthyerve.*

Ne shohim se shpesh, të kthyerit kthehen në ambiente familjare për ta ku ata kanë të njohur, miq dhe kontakte. Kjo do të thotë se qytetet që i panë këta njerëz të largohen, mund të presin që disa prej tyre të kthehen. Këto janë qytetet që duhet të jenë të parët për t'u përgatitur për të kthyerit.

<sup>4</sup> Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë (AIVD). (2017). Fokusi te të kthyerit. Marrë nga [https://english.aivd.nl/binaries/aivd-en/documents/publications/2017/02/15/publication-focus-on-returnees/Terugkeerders+in+beeld\\_ENG\\_WEB.pdf](https://english.aivd.nl/binaries/aivd-en/documents/publications/2017/02/15/publication-focus-on-returnees/Terugkeerders+in+beeld_ENG_WEB.pdf)

<sup>5</sup> Koordinator Kombëtar Holandez për Sigurinë dhe Kundërterrorizmin (NCTV) dhe Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë (AIVD). (2017). Fëmijët e ISIS-it: Indoktrinimi i të miturve në territoret e kontrolluara nga ISIS-i. Marrë nga [https://english.aivd.nl/binaries/aivd-en/documents/publications/2017/04/26/the-children-of-isis.-the-indoctrination-of-minors-in-isis-held-territory/WEB\\_Minderjarigen\\_bij\\_ISIS\\_ENG.pdf](https://english.aivd.nl/binaries/aivd-en/documents/publications/2017/04/26/the-children-of-isis.-the-indoctrination-of-minors-in-isis-held-territory/WEB_Minderjarigen_bij_ISIS_ENG.pdf)

<sup>6</sup> Koordinator Kombëtar Holandez për Sigurinë dhe Kundërterrorizmin (NCTV). (2017). Përjasja gjithëpërfshirëse për të kthyerit. Marrë nga [https://english.nctv.nl/binaries/Factsheet%20NCTV%20Terugkeerders%20ENG\\_tcm32-244754.pdf](https://english.nctv.nl/binaries/Factsheet%20NCTV%20Terugkeerders%20ENG_tcm32-244754.pdf)

**Rreth roleve multi-agjenci, përgjegjësi të ndara, roleve të ndryshme për policinë dhe rreth këtij dokumenti**

Puna për parandalimin e suksesshëm dhe daljen kërkojnë veprime të orkestruara dhe ndërhyrjen e të gjitha organizatave të përfshira qeveritare dhe joqeveritare. Nga gama e aktiviteteve dhe ndërhyrjeve që nevojitet, shohim se ka pikëpamje të ndryshme në Evropë nëse këto janë apo jo detyrë bazë e policisë.


Skemat multi-agjenci duhet të përfshijnë policinë dhe palë jopolicore. Kjo duhet të organizohet nga një perspektivë me përgjegjësi të përbashkëta. Policia, në nivel lokal, është e mirëpozicionuar për të nisur ose mundësuar punën e kërkuar multi-agjenci. Të gjitha palët dhe organizuesi i skemës multi-agjenci duhet të operojnë nga i njëjti kuadër. Kjo do të thotë se jo gjithmonë mund të përcaktoni se cili është ose nuk është roli i policisë. Edhe nëse diçka nuk është nën tutelën e policisë, është e nevojshme që policia të dijë dhe të përdorë të njëjtin përkufizim sfidash dhe reagimet multi-agjenci.

Kjo është arsyeja pse në këtë dokument ka edhe informacion kontekstual, që është më i gjerë se roli strikt i policisë.

**Roli i policisë**

- Për shkak të mungesës së forcës punonjëse dhe burimeve, agjencitë e inteligjencës i kërkojnë policisë të monitorojë të gjithë individët me rrezikshmëri.
- Duke qenë se shumë të kthyer janë persona të mbyllur, është nevoja për monitorim dhe grumbullim informacioni të vazhdueshëm në nivel lokal. Policia mund ta mundësojë dhe ta organizojë këtë dhe të shërbejë si lidhje mes agjencive të inteligjencës, qeverisë lokale dhe organizatave dhe institucioneve të tjera lokale.
- Policia mund të jetë nismëtarja, mbështetësja ose organizuesja e multi-agjencisë së kërkuar.

Figura 1 Përqsja holandeze për të kthyerit



## 1. Grumbullimi i informacionit dhe përgatitjet pas nisjes së dikujt për në Siri ose Irak, përpara kthimit dhe pas kthimit

### Sfida

Me gjithë dështimin për të mos i lejuar njerëzit të udhëtojnë dhe të mbërrin në Siri, Irak ose fuqshëbeteja të tjera xhihadiste, ka ende punë për t'u bërë. Ekziston rreziku që motrat ose vëllezërit dhe personat e përafërt të bëhen objektiv për t'u rekrutuar nga jashtë vendit. Prindërit kanë nevojë për mbështetje për të përballuar këtë ngjarje traumatizuese ose mund të kenë nevojë për udhëzime për kontaktin me pjesëtarin e familjes në Siri ose Irak. Në shumë shtete, është nxjerrë një mësim i mirë nga moskryerja e një vlerësimi të duhur të dobësive dhe rezistencës së motrave/vëllezërve ose personave të përafërt: rekrutimi zinxhir ka parë tri motra që kanë ndjekur të vëllain, dhe shokët që kanë ndjekur rrugën e shokut e tyre, duke përdorur të njëjtat rrjete trafikimi dhe kontakte xhihadiste.

Ekziston gjithashtu një nevojë për të grumbulluar informacione rreth personave që janë larguar: Çfarë bëjnë ata jashtë shtetit? A mund të bëjmë një vlerësim të qëllimeve të tyre reale për kthimin? A mund të ndërtojnë ata një rreth social që mund të ofrojë një shans për risocializim, deradikalizim apo shkëputje, në rastet e duhura? A mund ta fuqizojmë në familjen që të jetë faktor mbrojtës dhe mbështetës, për mbrojtjen e fëmijëve të tyre të tjerë dhe për djalin ose vajzën e kthyer?

### Zgjidhjet dhe përqsjet

#### Hapni një dosje dhe përgatitni kontekstin policor dhe multi-agjenci

Dosjet duhet të hapen për të gjithë individët që largohen, për të ndihmuar ndjekjen dhe hetimin si edhe parandalimin dhe risocializimin.

- Kërkoni për një kontekst ekzistues multi-agjenci që ofron një platformë për grumbullimin dhe vlerësimin e informacionit nga palë të ndryshme, dhe që mund të funksionojë si arenë për të diskutuar dhe hartuar programe ndërhyrjeje të personalizuar.
- Përdorni skemat ekzistuese sepse ato mund të kenë tashmë lidhje pune, procese dhe protokolle pune të besueshme për të ndihmuar në dhënien e rezultatit të kërkuar. Ndërgjegjësimi dhe besimi mes palëve multi-agjenci dhe efikasiteti i tyre mund të shtohen me një sesion trajnimi mbi të kthyerit për palët kyçe në bashkëpunimin multi-agjenci. Të kthyerit me fëmijë do të kërkojnë bashkëpunim multi-agjenci për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e abuzimit.
- Protokollet ekzistuese të ndarjes së informacioneve duhet të testohen duke përdorur raste nga jeta reale. Nëse rezulton se protokollet duhen përmirësuar ose shpjeguar, merrni masa për ta bërë këtë. Kjo mund të testojë gjithashtu nëse legjislacioni ekzistues është sipas standardit apo ka nevojë për rregullime.



### **Praktikë interesante: Shtylla për kolegët**

Një njësi policie lokale në Hagë krijoi një “Shtyllë Kundër Terrorizmit dhe Radikalizimit Ekstrem” të ekspertëve të policisë, që mund të konsultohen me kolegë që nuk janë familjarizuar plotësisht me ekstremizmin dhe të kthyerit. Një oficer “shtyllë” është i disponueshëm për konsultim 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Ka gjithashtu një manual të brendshëm për të gjithë oficerët, me udhëzime për t’u ndjekur nëse një individ duket se është subjekt i radikalizimit dhe është i gatshëm të bashkohet me lëvizjet terroriste. Një prej kapitujve titullohet “Çfarë duhet të bëni kur një i kthyer shfaqet në radar”, dhe përcakton se kush duhet kontaktuar dhe çfarë duhet të regjistruar në sistemet e policisë. Megjithatë, e gjitha kjo është me orientim drejt ndjekjes dhe hetimit, dhe nuk është përgatitur duke pasur parasysh parandalimin dhe deradikalizimin.

### Përfshirja me të larguarin dhe familjen

Në Aarhus (Danimarkë), Bavari (Gjermani), Holandë dhe tjetërkund në Evropë, policia përpiqet të përfshihet me familjet sapo dikush largohet. Ata mund ta bëjnë këtë edhe më herët gjatë këtij procesi, në fazën e mëparshme kur prindërit dhe të tjerët janë të shqetësuar rreth rrezikut të radikalizimit dhe rekrutimit të mundshëm. Shumica e familjeve kanë nevojë të kuptojnë situatën, si mund ta kthejnë fëmijën sërish dhe çfarë ndodh pasi fëmija kthehet sërish në vend. Përfshirja duhet të kryhet nga pjesëtarë policie me aftësinë dhe ekspertizën e duhur, si p.sh. oficerët e kontakteve me policinë ose një oficer i besuar policie në komunitet. Megjithëse ata identifikohen si policë, detyra e tyre kryesore është të mbështesin familjen në çështjet e policisë.

Kyç mbetet ndërtimi i një marrëdhënieje me të kthyerit dhe familjet e tyre. Kjo do të thotë se policia duhet të jetë pragmatike: personaliteti dhe marrëdhëniet ekzistuese të oficerëve të policisë janë të rëndësishme, dhe nëse përzgjedhja e oficerëve aktualë nuk funksionon, atëherë oficeri i policisë mund të zëvendësohet, ose mund t’i kërkohet një agjencie apo institucioni tjetër të përfshihet me familjen. Nuk është e domosdoshme që të jetë policia që e ndërton këtë marrëdhënie, por policia duhet të jetë e përfshirë.

**Praktikë interesante:**

**Përdorni gjashtë parimet e influencës të Cialdinit**

Në takimin e RAN POL, pjesëmarrësit u frymëzuan nga një prezantim mbi vlerën e shtuar të përdorimit të teknikave të negocimit për pengjet për të ndërtuar një marrëdhënie pune me dikë që ka qëndrim armiqësor ndaj policisë. Si mund ta bindni këtë person të ndajë informacione dhe të bashkëpunojë me policinë dhe agjenci të tjera? Prezantimi fokusohet në përdorimin e qëllimshëm të gjashtë parimeve të influencës (**konsistenca, reciprociteti, pëlqimi, prova sociale, autoriteti dhe pamjaftueshmëria**), bazuar në librin e psikologut Robert B. Cialdini *Influencia*, psikologjia për të bindur<sup>7</sup>. Ne duhet të theksojmë se teknikat e influencës u identifikuan si mundësisht shumë të dobishme në afrimin dhe influencimin me sukses të të kthyerve dhe familjeve të tyre. Teknikat janë ose duhet të jenë pjesë e programit të trajnimit të policisë; në disa shtete, oficerët parandalues mund të përfitojnë nga një kurs rifreskues.

**Pritja e fëmijëve**

Fëmijët shihen pikësëpari dhe më së shumti si viktima. Por, bazuar në ngjarjet në Siri dhe Irak, fëmijët që në moshën nëntë vjeçare mund të përbëjnë rrezik, qoftë në planin afatshkurtër ose afatgjatë. Nëse babai ose nëna e kthyer janë të arrestuar ose në burg, hyjnë në skenë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve. Të gjithë të kthyerit fëmijë kanë nevojë për vlerësim dhe ndoshta për kujdes të veçantë për shembull për traumat e mundshme dhe rikthimin në shkollë. Për këtë arsye, fëmija duhet të vlerësohet nga një numër perspektivash, dhe mund të kalojnë muaj ose edhe vite përpara se të paraqiten sjelljet e rrezikshme. Mësimet e nxjerra nga trajtimi i ushtarëve fëmijë dhe fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi apo abuzimeve seksuale, tregojnë si zgjidhje trajtimin përmes përfshirjes dhe ndërhyrjes afatgjatë, përmes specialistëve dhe jo policisë. Roli i policisë është të përcaktojë se si të bëhet përfshirja me fëmijët që mund të kenë qenë dëshmitarë, viktima ose autorë të krimeve. Ne mund të mësojmë nga përvoja e policisë në trajtimin e abuzimit të fëmijëve dhe dhunës në shtëpi, ku policia ka përdorur ekspertë me përjasje të specializuara dhe delikate. “Parimi i moslëndimit” tregon se duhen shmangur veprimet që mund të shkaktojnë më shumë trauma dytësore dhe si rrjedhojë më shumë vulnerabilitet.

<sup>7</sup> Wikipedia. (24 mars 2017). Robert Cialdini. Marrë nga [https://en.wikipedia.org/wiki/Robert\\_Cialdini](https://en.wikipedia.org/wiki/Robert_Cialdini)

## Në burg? Një dritare mundësie për të ndërtuar marrëdhënie

Në shumicën e shteteve, me ndryshimet në legjislacion udhëtimi në Siri dhe Irak është subjekt i ligjeve të kundërterrorizmit. Prandaj, në shumicën e shteteve, të kthyerit arrestohen dhe u jepet dënim me burg. Kjo është një dritare mundësie për t'iu afruar këtyre individëve. Në disa shtete në Gjermani, policia lejohet t'i afrohet një të kthyeri të burgosur dhe të nisë një dialog për daljen dhe risocializimin. Është e logjikshme që të përpiqeni të mbani kontakt me të kthyerit përmes të gjitha fazave: para nisjes, gjatë kohës që janë jashtë vendit, pas kthimit, në burg dhe kur lirohen nga burgju.

Dënimet me burg të të kthyerve i japin gjithashtu kohë policisë që të diskutojë me familjet rreth temës se çfarë do të ndodhë me të kthyerin kur të lirohet. Pyetjet që mund të drejtohen janë “Çfarë doni për djalin/vajzën tuaj”, “Si e shikoni ju rolin tuaj”, dhe “Si mund t’ju mbështesim për këtë”? Natyrisht, jo të gjitha familjet ose partnerët do të jenë të hapur ndaj këtij dialogu, por gjithsesi duhet të përpiqemi t’u afrohem atyre. Në disa shtete evropiane veriperëndimore, policia është pala që zhvillon këto biseda. Sigurisht, këtë mund ta bëjë edhe një punonjës i komunës ose OIQ. Për policinë është e rëndësishme që të krijohet një lidhje me palën që përfshihet me të kthyerin ose familjen.

### Roli i policisë

- Të japë kontribut në sensin e urgjencës në lidhje me çështjen e të kthyerit, dhe të ndihmojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e ekspertizës në trajtimin me të kthyerit.
- Pas mbërritjes, i kthyeri do të kontaktohet gjithmonë nga policia dhe madje mund të arrestohet për qëllime hetimi. Përmes këtij kontakti, policia mund të vlerësojë nevojat e të kthyerve dhe potencialin për bashkëpunim, dhe përdor parimet e influencës për të krijuar një lidhje që rezulton në shtim të informacioneve të besueshme dhe më shumë mundësi për përfshirje dhe bashkëpunim.
- Nga perspektiva e policisë, zhvillohen dy procese:
  - I) ndjekja dhe hetimi;
  - II) parandalimi dhe përfshirja me të kthyerin dhe familjen e tij:
    - krijimi i kontaktit me të kthyerin dhe familjen e tij sa më shpejt të jetë e mundur në proces dhe garantimi që motrat/vëllezërit janë të mbrojtur;
    - ndërtimi i një marrëdhënieje me familjen ose t’i kërkohet një agjencie tjetër ta bëjë këtë;
- Punoni me një oficer kontakti të familjes, një oficer policie në komunitet ose parandalues, ose madje edhe një kontakt jopolicor;
- Sigurohuni që oficerët e policisë të dinë protokollet dhe të kenë ekspertizën e kërkuar për të punuar në një kontekst multi-agjenci me të kthyerit dhe individët e radikalizuar nga brenda vendit.

## 2. Vlerësimet: rreziku, kërcënimi, vulnerabiliteti, mundësia për të ndryshuar

### Sfida

Policia duhet të konsiderojë pyetjet e mëposhtme: “Kush është ky person”, “Çfarë lëvizjesh ka bërë — a ka ndonjë gjë që mund të përdoret kundër tij në gjyq?”, “Cilat janë qëllimet dhe planet e tij?” dhe “A është ky person i rrezikshëm apo dikush i penduar që dëshiron të risocializohet në shoqëri?”

Në përgjithësi, në diskutim u vunë re dy lloje të ndryshme vlerësimi:

- një vlerësim fillestar i kryer nga agjencia e inteligjencës, me ndihmën e policisë dhe të tjerëve, duke u fokusuar pikësisht te rreziqet dhe kërcënimet;
- më vonë në proces, në nivel lokal, një vlerësim për një program të personalizuar për të lehtësuar rreziqet dhe për të synuar risocializimin, shkëputjen dhe deradikalizimin.

### Zgjidhjet

Sfida ose detyra e parë është hetimi penal dhe analiza e kërcënimit në lidhje me sigurinë kombëtare. Kjo duhet të trajtojë gjithashtu elemente të problemeve ose nevojave përkatëse fizike dhe/ose psikologjike. Vlerësimi i rrezikut fillestar mund të kryhet nga shërbimi i inteligjencës.

Ka gjithashtu një numër modelesh të vlerësimit të rrezikut në përdorim nga policia dhe në bashkëpunim multi-agjenci: p.sh. VERA 21<sup>8</sup>, ERG 22+ dhe IR46. Ato të gjitha funksionojnë me listat e treguesve për faktorë të ndryshëm: (i) bindjet dhe sjelljet, (ii) konteksti dhe qëllimi, (iii) historiku dhe aftësitë, (iv) përkushtimi dhe motivimi, dhe (v) rrethanat mbrojtëse (të marra nga VERA).

Përfaqja e Mbretërisë së Bashkuar e quajtur “Udhëzuesi Channel” përdor një kuadër që mbulon 22 faktorë<sup>9</sup> që mund të shkaktojnë që dikush të bëjë një ose më shumë nga të mëposhtmet: (i) të përfshihet me një grup, kauzë ose ideologji terroriste; (ii) të zhvillojë qëllimin për të shkakuar dëmtime; ose (iii) të zhvillojë aftësinë për të shkakuar dëmtime.

- Shumica e mjeteve funksionojnë me të dhënat historike, që mund ta ndihmojë policinë të dallojë një ndryshim në sjellje me kalimin e kohës. Problemi me shumicën e të kthyerve është se ka një boshllëk mes të dhënave gjatë qëndrimit të tyre në të ashtuquajturin kalifat. Kjo e bën edhe më të rëndësishme fillimin e rivlerësimit rregullisht të personit pas kthimit të tij, duke plotësuar të dhënat me informacione bazuar në veprimet e tij.

<sup>8</sup> Qeveria e Kanadasë. (2009). VERA: Violent Extremist Risk Assessment dhe instrumenti SPJ. Vendimet për Vlerësimin e Rrezikut për Ekstremizmin e Dhunshëm Politik 2009-02. Ottawa. Marrë nga <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/2009-02-rdv/index-en.aspx#Appendix>

<sup>9</sup> Ministria e Brendshme. (2012). Channel: Kuadri i vlerësimit të vulnerabilitetit. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Marrë nga [https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/118187/vul-assessment.pdf](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/118187/vul-assessment.pdf) online

- Ekspertët në takimin e Dyseldorfit vërejtën se do të siguroheshin nëse mjetet e tyre të vlerësimit të rrezikut mund të përdorëshin për të vlerësuar gratë dhe fëmijët.
- Në lidhje me pyetjet se si dhe kur të intervistoheshin të miturit, ne duhet të shfrytëzojmë përvojën e fituar nga rastet që përfshijnë fëmijët, dhunën në shtëpi dhe abuzimin e fëmijëve.

#### Vlerësimi lokal i rrezeve, nevojave dhe potencialit për ndryshim

Vlerësimi në nivel lokal nuk duhet të fokusohet vetëm te rreziqet. Ai ka për qëllim të mbështesë vlerësimin e rrezikut, por duhet të ndihmojë në krijimin e planeve të personalizuara për individët. Prandaj, pjesë të caktuara të vlerësimit mund të jetë më të orientuara drejt kujdesit dhe risocializimit.

#### **Praktikë interesante:**

##### **Vlerësimi në shtëpinë e sigurisë multi-agjenci**

Në Hagë (Holandë), vlerësimi i rrezikut dhe analiza e rrjetit kryhen në një kontekst multi-agjenci, nën përgjegjësinë e komunës lokale, së bashku me prokurorët, policinë dhe partnerë të tjerë si shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet e lirimt me kusht dhe partnerë të tjerë të kujdesit dhe sigurisë. Ajo është projektuar të trajtojë çështje serioze me shumë probleme dhe të punojë me formulën “Një familje, një plan, një drejtues”, dhe ka qenë në përdorim përpara se të lindte sfida e të kthyerve.

#### Kush e kryen vlerësimin në nivel lokal?

Opsionet e ndryshme janë të disponueshme. Vlerësimi mund të organizohet nga:

- Policia
- Autoritetet lokale
- Institucionet me përgjegjësi të përbashkëta.

#### Ndarja dhe vlerësimi i informacionit

Ndarja e informacionit është gjithmonë sfidë. Dhe ndonjëherë, është më e lehtë të arrihet në nivel specialisti sesa në nivel menaxhimi. Shtete të ndryshme përdorin mjete të ndryshme për të arritur këtë. Në Mbretërinë e Bashkuar, seancat gjyqësore me dyer të mbyllura lejojnë ndarjen e informacioneve më sekrete. Policia britanike gjithashtu kanë filluar bashkëpunimin e ngushtë me shërbimet e shëndetit mendor në të ashtuquajturat

Qendra të Shëndetit Mendor<sup>10</sup>. Në Holandë, përdoret modeli IR46, që vlerëson 46 tregues. Ndonjëherë, rezultati për një tregues të caktuar tregohet pa zbuluar burimin dhe sjelljen e saktë. Danimarka përdor shtëpitë e sigurisë multi-agjenci dhe jo vetëm lejohet ndarja e informacioneve, por është përgjegjësi legislative.

<sup>10</sup> Këshilli Kombëtar i Shefave të Policisë (NPCC). (n.d.). Qendrat pilot të shëndetit mendor. Marrë nga <http://www.npcc.police.uk/NPCCBusinessAreas/TAM/MentalHealthPilotHubs.aspx>

Ekziston gjithashtu edhe opsioni për të punuar me “formën e fjalëve”, një mënyrë formulimi i rënë dakord që tregon diçka pa qenë të qartë, ose për të “normalizuar” informacionin në mënyrë që të mund të ndahet. Disponohet më shumë informacion në dokumentin aktual të vitit 2017 të RAN POL<sup>11</sup> rreth përfshirjes së policisë në ndarjen e informacioneve dhe punën me multi-agjenci.

### Roli i policisë

- Vazhdoni t’u shpjegoni palëve të tjera pse keni nevojë për informacione të caktuara ose pse policia nuk mund të ndajë informacione të caktuara.
- Shërbeni si pikë lidhjeje me shërbimet e inteligjencës.
- Këshilloni palët e tjera rreth sigurisë (personale).
- Ndërkohë që policia mund të ketë informacione dhe ekspertizë të konsiderueshme për vlerësimin, sigurisht që nuk janë ata që duhet ta bëjnë këtë.

## Puna e daljes: zbutja e rrezikut dhe ofrimi i një alternative

### Sfida

Të kthyerit duhet të ndihmohen të risocializohen — edhe të kthyerit që duhet të burgosen ka të ngjarë që të kthehen në shoqëri në një moment të caktuar. Në atë moment, zgjedhja është mes mosveprimit, monitorimit dhe/ose asistimit me punë daljeje dhe risocializim. Risocializimi është i rëndësishëm, jo vetëm sepse i udhëzon të kthyerit të bëhen “qytetarë të mirë”, por më e rëndësishmja, sepse është një prej pak strategjive pozitive për të minimizuar rrezikun e ekstremizmit të dhunshëm. Risocializimi dhe rehabilitimi e bëjnë shoqërinë më të sigurt.

Në identitetin e individëve të radikalizuar shpesh ka depërtuar ekstremizmi. Idealet, mjedisi shoqëror dhe puna e përditshme, të gjitha këto që përcaktojnë identitetin e dikujt, i përkushtohen ekskluzivisht ambientit radikal. Që individët ta lënë pas këtë me sukses, duhet të ofrohet një alternativë praktike. Procesi i punës së daljes për këtë arsye përfshin si dekonstrukcionin e kontekstit ekstremist ashtu edhe ndërtimin e një konteksti joekstremist.

<sup>11</sup> Radicalisation Awareness Network (RAN). (2017). Dokumenti aktual i RAN POL: “Roli i oficerëve të policisë në ndarjen e informacioneve dhe punën me multi-agjenci”. Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran/ran-pol/docs/ran\\_pol\\_role\\_for\\_police\\_officers\\_utrecht\\_212016\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-pol/docs/ran_pol_role_for_police_officers_utrecht_212016_en.pdf)



POL

## Zgjidhjet

Kjo nuk është një sfidë krejtësisht e re, dhe neve nuk na duhet të gjejmë zgjidhje krejtësisht të reja. Mund të aplikohen, deri në një farë shkalle, mësimet e nxjerra nga rehabilitimi i të burgosurve të tjerë “të paradikalizuar”. Më e rëndësishmja, shumë shtete brenda BE-së kanë organizata dhe projekte të përfshira në shkëputjen dhe deradikalizimin e ekstremistëve të dhunshëm<sup>12</sup>.

Grupi i punës së RAN Exit ka hartuar disa mësimet thelbësore për punën e suksesshme të daljes në dy dokumente: *Kërkesat minimale metodologjike për ndërhyrjet e daljes*<sup>13</sup> dhe *Hartimi i një ndërhyrjeje për daljen*<sup>14</sup>. Secili rast në punën e daljes duhet të përshtatet me rrethanat specifike të rastit. Në këtë sens, përgatitjet për ndërhyrjen e daljes për të kthyerit nuk janë të ndryshme nga rastet e tjera. Por, duke qenë se të kthyerit mund të kenë përjetuar dhunë, mund të jenë të traumatizuar dhe kanë marrë trajnim ushtarak dhe/ose ideologjik, mund të kërkohen disa masa shtesë. Këto masa përfshijnë sa më poshtë:

- Ndiurma mendore ose fizike. Lëndimet ose trauma, si fizike ashtu dhe mendore, duhet të trajtohet përpara çdo ndërhyrjeje daljeje.
- Të kthyerit nga ISIS-i kanë marrë trajnim ideologjik. Dhe megjithëse punonjësit jofetarë për daljen janë plotësisht të aftë të diskutojnë rreth ideologjive, mund të jetë e dobishme mbështetja nga një ekspert teologjik ose një imam.
- Mund të kërkohen masa sigurie shtesë, për sigurinë e punonjësit për daljen dhe të klientit. Më shumë detaje mund të gjenden në faqen 6 të dokumentit aktual *Hartimi i një ndërhyrjeje për daljen*.

<sup>12</sup> Radicalisation Awareness Network (RAN). (12 maj 2017). RAN Collection: Strategjitë e daljes. Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-best-practices/ran-exit-strategies\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/ran-exit-strategies_en)

<sup>13</sup> Radicalisation Awareness Network. (2016). Dokumenti aktual i RAN EXIT: “Kërkesat minimale metodologjike për ndërhyrjet e daljes”. Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran/ran-exit/docs/ran\\_exit-ex\\_post\\_paper\\_london\\_15-16032016\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-exit/docs/ran_exit-ex_post_paper_london_15-16032016_en.pdf)

<sup>14</sup> Radicalisation Awareness Network. (2017). Dokumenti aktual i RAN EXIT: “Hartimi i një ndërhyrjeje për daljen”. Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran/ran-exit/docs/ran\\_exit\\_setting\\_up\\_exit\\_intervention\\_berlin\\_13-14\\_022017\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-exit/docs/ran_exit_setting_up_exit_intervention_berlin_13-14_022017_en.pdf)

### Roli i policisë

Roli i policisë në punën e daljes dhe risocializimit do të varen nga shteti dhe nga marrëdhëniet me të kthyerin. Suksesi i punës së daljes varet shumë nga mirëbesimi dhe gatishmëria e klientit. Në shumicën e Shteteve anëtare, një program daljeje i organizuar nga qeveria do të ketë probleme me kredibilitetin në sytë e grupit të synuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për të kthyerit, që shpesh janë burgosur dhe mbeten nën mbikëqyrjen e rreptë nga e njëjta qeveri. Por, duke qenë se monitorimi dhe ruajtja janë detyra paralele gjatë procesit të risocializimit të të kthyerve, policia nuk mund të përjashtohet.

Ne dallojnë tre role të ndryshme që mund të marrë policia gjatë procesit të daljes dhe të risocializimit.

- Policia si një prej partnereve në daljen multi-agjenci

Në shumicën e shteteve, programi i daljes do të organizohet nga një organizatë joqeveritare (OJQ). OJQ-të veprojnë në mënyrë të pavarur nga qeveria, kjo u lejon atyre të ndërtojnë besim dhe kredibilitet me klientin. Duke qenë se bashkëpunimi me policinë mund ta shkelë këtë besim, duhet të ketë marrëveshje dhe procese të qarta në lidhje me ndarjen e informacionit. Është thelbësore transparenca mes agjencive të përfshira dhe drejt klientit. Koordinimi i programit të risocializimit do të jetë përgjegjësi e komunës ose e organizatës së daljes. Policia mund të përfshihet nëse ka shqetësime rreth sigurisë, qoftë nga ana e tyre ose nga ana e një prej agjencive të tjera që përfshihen.

- Koordinimi i policisë dhe drejtimi i daljes multi-agjenci

Në disa shtete (p.sh. Bavaria në Gjermani), koordinimi i programit të daljes dhe risocializimit janë përgjegjësi e policisë. Në këtë rast, policia vendos se cila OJQ do të përfshihet në ndërhyrjen e daljes. Ana pozitive e kësaj strukture organizative është se policia ka kontroll më të madh në monitorimin e procesit të risocializimit dhe aspekteve të sigurisë. Ana negative e kësaj marrëdhënieje të ngushtë me policinë është se mund të kufizojë gatishmërinë e klientit për të bashkëpunuar. Ky disavantazh është shqetësim serioz: siç deklaroi qartë grupi i punës së RAN Exit, klientët nuk mund të detyrohen të shpëtohen ose të deradikalizohen.

- Zbatimi i programit të daljes direkt nga policia

Ka situata në të cilat policia ka marrëdhënie aq të ngushta me klientin sa mund ta zbatojnë direkt ndërhyrjen e daljes (p.sh. Aarhus në Danimarkë). Policia zhvillon bisedimet e daljes. Në këto raste, është e rëndësishme që policia të ketë ekspertizën profesionale të kërkuar për të implementuar ndërhyrjet e daljes. Personeli i policisë duhet të trajnohet dhe duhet të ekzistojnë kushtet e tjera paraprake për punën e suksesshme të daljes (shikoni dokumentin aktual të përmendur më herët në këtë paragraf). Avantazhi këtu është aksesimi në informacionin e policisë dhe rreziku i reduktuar i gabimeve në komunikim në bashkëpunimin multi-agjenci. Megjithatë, këto marrëdhënie të besueshme mes policisë dhe klientit janë shumë të rralla.



Në përfundim: për shkak të një vlerësimi të duhur të sigurisë kombëtare dhe të sigurisë personale të profesionistëve të përfshirë, policia duhet të ketë lidhje të ngushta me punën e daljes. Pyetja kryesore është “Çfarë funksion?”. Përfshirja e policisë mund ta pengojë ose ta ndihmojë punën e daljes. Që puna e daljes të sjellë rezultatet e nevojshme, konteksti lokal do të përcaktojë se cili mund të jetë roli optimal për policinë, duke parë çështjen e mirëbesimit dhe natyrën vullnetare të daljes.

## 4. Mbrojtja e mjedisit

### Sfidat

Lejimi i dikujt me histori ekstremiste për t’u kthyer në shoqëri përbën dy sfida në lidhje me mbrojtjen. Një sfidë është në lidhje me mjedisin e drejtpërdrejtë të të kthyerit: vëllezërit/motrat, personat e përafërt dhe të tjerët pranë të kthyerit. A janë ata rezistentë dhe në gjendje të kundërshtojnë rreziqet e mundshme dhe ndikimet negative që shoqërojnë të kthyerit?

Sfida tjetër lidhet me rrjetet ekzistuese ekstremiste. Si është e mundur që të shmangen këto rrjete duke përfituar nga ekspertiza, statusi dhe aftësitë që ka zhvilluar një i kthyer gjatë kohës që ka qenë jashtë vendit? Dhe si të mbrohet i kthyeri nga frikësimi apo influenza nga këto rrjete?

### Zgjidhjet

#### Mbështetja e familjes

Për mjedisin e drejtpërdrejtë, është shumë me vend që të vlerësohet vulnerabiliteti dhe rezistenca. Familjet mund të jenë partneri më i rëndësishëm në procesin e risocializimit, por ato mund të veprojnë gjithashtu edhe si influencë negative. Vlerësimi ndihmon për të përcaktuar mbështetjen për të cilën ka nevojë familja, punën me faktorët e rrezikut dhe të mbrojtjes, dhe për t’i bërë rezistentë anëtarët e familjes dhe sistemin e familjes. Rezistenca e familjes mund të përcaktohet në përgjithësi si një proces dinamik i familjeve (që janë ekspozuar ndaj një elementi stresues ose fatkeqësie të konsiderueshme), që kërkon faktorët mbrojtës dhe rikuperues, të identifikuar si të dobishëm nga familja dhe anëtarët e familjes, për të promovuar përballimin e shëndetshëm. Prindërit duhet të tregojnë se ata i kuptojnë rreziqet dhe rolin e tyre si prindër ndaj të kthyerve dhe fëmijëve të tjerë.

Shumica e punës që lidhet me mbështetjen e familjes nuk është punë e policisë. Është thelbësore që policia të jetë e ndërgjegjshme rreth çfarë duhet bërë dhe çfarë nuk duhet bërë gjatë kësaj pune, dhe të mos shqetësojë në mënyrë të panevojshme procesin e mbështetjes së familjes<sup>15</sup>.

<sup>15</sup> Grupi i punës RAN Youth, Families and Communities (RAN YF&C). (2016). Dokument aktual: “Mbështetja e familjes: çfarë funksionon?”. Marrë nga [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/ran\\_ex-post\\_paper\\_family\\_support\\_29-30\\_september\\_manchester\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ran_ex-post_paper_family_support_29-30_september_manchester_en.pdf)

Policia mund të kontribuojë në analizën e familjes dhe të grupeve të përafërta me informacionin e vet dhe informacionin që merr nga partnerët. Në Aarhus (DK) policia ofroi mundësinë që familjet të takohen pa policinë të pranishme në takim.

#### Trajtimi i rrjeteve ekzistuese ekstremiste

Marrëdhënia mes një ish-anëtari të një grupi ekstremist, dhe rrjeteve ekzistuese është një dimension tjetër i mbrojtjes dhe i ruajtjes. Ne nuk mund të lejojmë që rrjetet ekzistuese të përfitojnë nga ekspertiza, statusi apo kontaktet e të kthyerit.

Shtetet e trajtojnë këtë çështje duke përdorur masa të ndryshme. Ndonjëherë, ato janë pjesë e një programi të personalizuar, që përmban incentiva si pozitive ashtu dhe negative.

Masat e mundshme për të mbrojtur mjedisin përfshijnë:

- Kufizimi i aksesit në median sociale;
- Kufizime në lëvizjet dhe kontaktet personale;
- Kufizimi i aksesit në media dhe shtyp;
- Angazhimi i detyrueshëm me një mentor;
- Mbikëqyrja elektronike.

Mënyra se si zbatohen këto masa ndryshon. Në Aarhus, ato vlerësojnë se çfarë efekti do të kenë veprime/kufizime/masa të caktuara në suksesin (ose dështimin) e risocializimit. Kjo bëhet së bashku me klientin, duke e bërë përgjegjësi të tyre që të bëjnë apo të vendosin të mos bëjnë diçka. Në shtete të tjera, këto masa janë pjesë përbërëse e një marrëveshjeje reciproke mes të kthyerit dhe drejtuesit të një oferte të personalizuar, bazuar në menaxhimin e çështjes multi-agjenci. Në Mbretërinë e Bashkuar, ato mund të jetë pjesë përbërëse e një Mase Hetimi për Parandalimin e Terrorizmit (TPIM). Ky është një urdhër civil që kërkon kufizimin e lëvizjeve/shoqërimeve të një personi në mënyrë që të lehtësohet rreziku që paraqesin ata: individët mund të transferohen në pjesë të tjera të shtetit, kontakti i tyre mund të jetë i kufizuar etj. TPIM synohet për personat që nuk mund të burgosen, por që konsiderohen të rrezikshëm. Individ civil mund të sfidojë TPIM (ose masa të veçanta të TPIM) në një seancë gjyqësore me dyer të mbyllura. Në të njëjtën kohë, implementohen ndërhyrjet e daljes. Masa e TPIM kërkon burime të jashtëzakonshme, dhe është aplikuar vetëm në pak raste, duke qenë se aplikohet kur shërbimi sekret e gjykon një situatë shumë të rrezikshme, pa pasur prova të mjaftueshme për ta ndjekur individin. Kjo situatë ndodh rrallë.

#### Komunikimi

Është gjithashtu e nevojshme të merren në konsideratë trazirat e mundshme sociale për shkak të “kthimit të një terroristi” në “rrugët ose shkollat tona”. Kjo kërkon një strategji inteligjente komunikimi dhe skenarë komunikimi për raste krize, nëse diçka shkon keq. Duke qenë se protesta publike lidhet me çështjet e sigurisë, është e nevojshme një përqasje e koordinuar komunikimi e autoriteteve vendore dhe policisë.

### Roli i policisë

Në nivel lokal, policia mund të ndihmojë nisjen dhe optimizimin e punës multi-agjenci që mund të mbrojnë mjedisin e ngushtë si edhe të mbrojnë shoqërinë. Kjo mund të kryhet gjithashtu edhe nën supervizionin e qeverisjes vendore, por në të dy skenarët, policia mund të kontribuojë me informacion dhe ekspertizë nga policia, dhe mund të jetë hallkë lidhëse me inteligjencën dhe forcën zbatuese të ligjit.

## 5. A është gati dhe e përgatitur policia për të kthyerit?

Përgjigjja e shkurtër është “jo”. Përgjigjja pak më e gjatë është “jo, por e dimë se çfarë duhet të bëjmë”.

Jo...

Përgjigjja e parë, “jo”, është për shkak të urgjencës së lartë të sfidës së të kthyerve. Si në shifra edhe në profil rreziku, ekziston nevoja që të shtohen përgatitjet për të gjitha palët, duke përfshirë edhe policinë. Në takimin e RAN POL, pjesëmarrësit parashikuan se departamentet e inteligjencës dhe shërbime sekrete nuk do të kenë burime dhe personel të mjaftueshëm për të monitoruar të kthyerit mundësisht të rrezikshëm. Dhe kjo nuk merr parasysh punën që duhet të bëjë për t’iu adresuar ekstremistëve xhihadistë “jo-udhëtues”. Ka shumë ekstremistë xhihadistë me rrënjë brenda vendit, të cilët përbëjnë rrezik të mundshëm, pa marrë trajnim në të ashtuquajturin kalifat. Dhe në disa shtete, janë edhe ekstremistët me rrezikshmëri të lartë të majtë dhe të djathtë.

Prandaj, nëse e kërkojnë zhvillimet thirret policia, dhe kjo mund të ndodhë gjithnjë e më shumë. Ka një vlerë të shtuar unike për policinë e afërt, për policinë që punon në lagje dhe me komunitetet, si dhe për policinë me lidhje të forta me inteligjencën kombëtare, dhe (ndonjëherë) me lidhje dhe marrëdhënie pune edhe më të forta me palët lokale. Kjo polici mund të luajë një rol në vlerësimin, zbutjen e rrezikut dhe mbrojtjen e familjeve dhe komuniteteve.

Vlen të përmendet që në disa takime të RAN POL, u shprehën shqetësime se këto veprime unike të policisë janë nën trysinë e shkurtimeve të buxhetit dhe riorganizimit. Ekziston rreziku i mbingarkimit të policisë lokale, duke mos i lejuar asaj të kontribuojë me rolet dhe cilësitë e veta unike parandaluese dhe përfshirëse.

### **... por e dimë se çfarë duhet të bëjmë**

Sfida është e re dhe urgjente në disa drejtime, por jo kaq shumë në të tjera: ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë. Në të gjithë Evropën, veçanërisht në Evropën veriperëndimore, policia e qytetit ka filluar të punojë për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit, duke përdorur praktika dhe përjasje që do të përdoren edhe për këtë sfidë. Ne nuk kemi nevojë për masa mbrojtëse dhe procedura krejtësisht të reja. Ne duhet të garantojmë që kapaciteti, rendimenti dhe impakti i bashkëpunimit ekzistues multi-agjenci në lidhje me ndarjen e informacionit, punën e daljes dhe masat mbrojtëse të jenë brenda standardit. Detyra e rëndësishme dhe përgjegjësia për autoritetet kombëtare dhe lokale dhe menaxhimin e të gjitha agjencive të përfshira policore dhe jopolicore është të ndërtohet mbi programet ekzistuese dhe të përmirësuara për rritjen e ndërgjegjësimit. Tani është koha që të optimizohet legjislacioni dhe protokollet për punën efikase multi-agjenci dhe ndarjen e informacionit. E dimë se çfarë duhet të bëjmë.

Dhe le të vazhdojmë të mësojmë. Sfidat evoluojnë: me shtimin e mësimave që nxjerrim nga sukseset dhe dështimet, duhet të vazhdojnë të mësojnë nga njëri-tjetri edhe ata që kryejnë vlerësime të rrezikut dhe punë daljeje në nivel bilateral, rajonal, lokal dhe kombëtar. RAN POL dhe grupet e tjera të punës dhe RAN Centre of Excellence do ta mundësojnë këtë aq sa e lejojnë burimet tona të kufizuara.

**Translated within:**

